



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM  
Nr. 6, datë 21.06.2024

**“Ftesë publike për bashkëpunim për Organizatat ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit si dhe për individët, ekspertë vendas e ndërkombëtarë si dhe për shtetas shqiptarë, me përvojë në fushat përkatëse, për të kontribuar me ekspertizën e tyre në përmbushje të qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar”**

Bazuar në nenet 24 dhe vijues të Regullores së Kuvendit dhe në pikën IX, të vendimit nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, me propozim të kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

VENDOSI:

1. T’u drejtohet me një **Ftesë publike për bashkëpunim**, Organizatave ndërkombëtare që veprojnë brenda dhe jashtë vendit si dhe individëve, ekspertë ndërkombëtarë dhe shtetas shqiptar jashtë vendit me përvojë të spikatur në fushat përkatëse që ofrojnë asistencë dhe ekspertizë në 3 fushat objekt pune të këtij komisioni, për të shprehur interesin për përfshirje aktive në nivel ekspertësh ose dhe në Sekretariatit Teknik, në tryezat e debatit publik si dhe për të kontribuar me ekspertizën e tyre në procesin që do të ndërtoj ky Komision dhe sidomos Grupi i Ekspertëve.
2. Të autorizojë kryesinë e Komisionit për të publikuar ftesën nëpërmjet kanaleve të informimit në dispozicion dhe për t’u komunikuar, organizatave e individëve të interesuar vendimin e Kuvendit, objektin e punës së komisionit, organizimin, kohën e veprimtarisë së tij dhe metodologjinë e angazhimit në këtë proces.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

FATMIR XHAFAJ

Miratuar më 21.06.2024